



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 140 prot.

Kamëz, më 24.10.2024

V E N D I M

Nr. 106.Datë 24/10 2024

M B I

**“MIRATIMIN E MANUALIT PËR PROÇEDURAT, PËR RREGULLAT, MËNYRAT DHE AFATET E TRAJTIMIT TË POSEDUESVE TË NDËRTIMEVE PA LEJE QË NUK LEGALIZOHEN DHE QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I AMFITEATRIT DHE FUSHAVE SPORTIVE, KËNDIT TË LOJËRAVE DHE SHKALLËVE PANORAMIKE NË LIQENIN E PASKUQANIT DHE ZGJERIMI I RRUGËS “HAJRI SKEJA” PASKUQAN”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 24.10.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.79 Datë 21.10.2024 në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr.44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative së Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr.22/2018 “Për strehimin social”; Ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proçeseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr.409, datë 15.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve pa leje që nuk legalizohen”; Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Kamëz me nr.919, prot, datë 17.10.2024 “Për mbledhjen e dokumentacionit dhe përgatitjen e dosjeve të subjekteve qe preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i amfiteatrit dhe fushave sportive, këndit të lojërave dhe shkallëve panoramike në liqenin e Paskuqanit dhe zgjerimi i rrugës “Hajri Skeja” Njësia Administrative Paskuqan; Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e manualit për proçedurat, për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga realizimi i projektit, “Ndërtimi i amfiteatrit dhe fushave sportive, këndit të lojërave dhe shkallëve panoramike në liqenin e Paskuqanit dhe zgjerimi i rrugës “Hajri Skeja” Paskuqan.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet grupi i punës i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë me nr.919 prot. datë 04.10.2024 “Për mbledhjen e dokumentacionit dhe përgatitjen e dosjeve të subjekteve që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i amfiteatrit dhe fushave sportive, këndit të lojërave dhe shkallëve panoramike në liqenin e Paskuqanit dhe zgjerimi i rrugës ”Hajri Skeja” Njësia Administrative Paskuqan.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

3. Manuali për procedurat, për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga realizimi i projektit, “Ndërtimi i amfiteatrit dhe fushave sportive, këndit të lojërave dhe shkallëve panoramike në liqenin e Paskuqanit dhe zgjerimi i rrugës “Hajri Skeja” Paskuqan, paraqitet në aneksin bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

N/KRYETAR KËSHILLI

MUNIR SHEHU

